

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm Penal,** gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lendën penale kundër të akuzuarit Sh.M nga ..., dhe mbrojtësit të tije av.H.C, nga ..., për shkak veprës penale, vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokuroris Themelore në Prizren PP.nr.781/11 të datës 26.05.2011, pas mabajtjes së seanceës të shqyrtimit kryesor, në prezencën e Prokurorës të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **23.01.2017**, morri dhe shapalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **Sh.M**, nga i ati M., e ëma L., e lindur ..., i lindur më dt...., në fsh...., tani me banim në ... rr.... Pnr. pronar I Hotel .../, ka të mbaruar arsimin e lartë, i martuar baba i 5 fëmijëve, drejtor biznesi, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Se prej datës së pavertetuar e deri me datën 31.01.2011, në objektin hotelier”...” në rr. ... në ..., me qëllim të përvetësimit të kundersligjshëm pasuror për vetë apo për personin tjetër, në shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të njëhësorit dhe konstatimit të shërbimit të specializuar të KEK-ut, është konstatuar se i pandehuri shfrytëzon energjinë elektrike përmes perqesve jashtë njëhësorit elektrik, në mënyrë të drejteperdrejte me perqes përmes nderpreresit 1-0-2, ku në pozitën 2 nuk regjistrohet energjia e shpenzuar, me ç’rast KEK-ut, divizioni të rrjetit në Prizren, I shkakton dëm material në shumën prej **15.194,10 euro**.

kësodor ka kryer veprën penale, vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 42, 43 par.1 p.1.3, 46, 49, 50, 52, 73, 74, 75 e 76 të KPK-së si dhe nenit 365 të KP-së, të akuzuarit i shqipton,

### D E N I M M E G J O B Ë

Në shumën prej **350 (treqidepesedhjetë) euro**, të cilën shumë të denimit me gjobë, i akuzuari është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse denimi me gjobë nuk ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet në denim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro një ditë burg, respektivisht **17 ditë burgim**,

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do të bëhen ato në bazë të llogaris së gjykatës, si dhe shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej **50,00 euro**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërsi së këtij aktgjykimi.

Perfaqësi i te demtuarës KEK-distrikti ne Prizren, për realizimin e kërkesës pasuroro – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar akatkuizën me PP.nr.781/11, të datës 26.05.2011, kundër të akuzuarit Sh.M nga ..., për shkak veprës penale, vjedhje nga neni 252 par.1 te KPK-së.

Prokuri i Shtetit Besim Susuri në fjalë përfundimtare ka deklaruar: se gjate shqyrtimit permes administrimit te provave se ndegjimit te deshmitareve te propozuar, si ne aktakuze, M.F, V.M, dhe F.S te cilet ditën kritike me dt.31.11.2011, kane qene ne vendin e ngjarjes ne kontrollim te objektit hotelier ... ne Prizren, dhe ate sipas urdhereses te punedhenesit te tyre.Per kete ata edhe kane perpiluar procesverbalin perkitazi me gjendjen e hasur ne vend ngjarje, procesverbal me nr.0721871 te dt.31.01.2011, ku qendron konstatimi se shfrytezuesi shfrytezon rrymen jashte njehsorit me kabell me nderprese, te vendosur 1-0-2 ku pozita 2 n2 njehsor nuk regjistron energjin e shpenzuar, nderkaq qendron konstatimi se eshte eliminuar keqeperdorimi nga punetoret e Kedsit gje qe u vertetua edhe gjate deshmitare se tyre me prezentimin e fotove nga shkresat e lendes. Gjithashtu permes prezentimit te provave si ne procesverbal nga vendi I ngjarjes dhe fotodokumentacioni me pamedyshje vertetohet se I pandehuri, Sh.M ehste kryeres I vepres penale te vjedhjes, nga neni 252 par.1 te KPK-se, ne kohen, vendin dhe menyren e pershkruar me per se afermi si ne dispozitiv te aktakuzes.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-distrikti ne Prizren z.B.P në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbeshtes ne teresi fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit, gjithashtu edhe parashtrrojme kerkesen pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.H.C në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit te provave nga ana e trupit gjykues, nuk eshte arritur te vertetohet aktakuza e prokurorisë si dhe konstatimi i bere nga ana e punetoreve te kedsit, procesverbali e cila ka qene pjese perberese e kesaj aktakuze, poashtu nga deklarimimi deshmitareve eshte vertetuar fakti se ne kohen-momentin kur kane shkuar ne kontrollim-inspektim shfrytezuesi I energjise elektrike, I mbrojturi im ne rastin konkret fare nuk ka qene prezent ne momentin kur eshte bere kontrollimi ne menyre qe vete ai personalisht ta sheh gjendjen reale te njehsorit elektrik. Ne pyetjen e cila eshte bere deshmitareve, te njejtit kane deklaruar se nuk jane ne dijeni se a ka qene apo jo vet prezent pronari pra i mbrojturi im, poashtu edhe gjendja e paisjeve e ila eshte konstatuar nga vete punetoret e kedsit kane deklaruar se nuk jane ne gjendje te dine gjendjen funksionale te tyre. Gjendja reale e fakti real eshte deklarata e te mbrojturit tim I cili tha para trupit gjykues, dhe trupi gjykues qe me rastin e marrjes se vendimit duhet qe te kete parasysh dhe te jep rendesi vendimarrje, e poashtu eshte konstatuar edhe fakti tjetër, se ne trafen e cila eshte konstatuar gjendja nuk ka qene i vetmi shpenzues i energjise elektrike por ka pasur edhe persona-pronar te firmave te tjera. Ne mungese te ketyre provave dhe fakteve, meqenese nuk dihet se cili eshte

personi I cili ka bere keqepedorime, I prpopozojme gjykates qe ndaj te mbrojturit tim te bie aktgjykim lirues, duke u bazuar ne mungese te provave.

I akuzauri Sh.M në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij av.H.C, dhe se nuk ka për të shtuar asgjë tjetër.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi te gjitha provat e nevojshme dhe pas analizimit te seciles prove veç e veç dhe ne baze te te gjithave vertetoi kete gjendje faktike:

Se prej dates se pavertetuar e deri me datën 31.01.2011, ne objektin hotelier”...” ne rr.... në ..., me qellim te pervesimit te kunderligjshem pasuror per vete apo per personin tjetër, ben shfrytezimin e paautorizuar te energjise elektrike, ne ate menyre qe gjate kontrollit te njehsorit dhe konstatimit te sherbimit te specializuar te KEK-ut, eshte konstatuar se i pandehuri shfrytezon energjine elektrike permes perqesve jashte njehsorit elektrik, ne menyre te drejteperdrejte me perqes permes nderpreresit 1-0-2, ku ne poziten 2 nuk regjistrohet energjia e shpenzuar, me ç’rast KEK-ut, divizioni te rrjetit ne Prizren, I shkakton dem material ne shumen prej **15.194,10 euro.**

Gjykata kete gjendje faktike e ka vertetuar edhe nga provat materiale, procesverbali me nr.0721871 i dt.31.01.2011, transakcionet e konsumatorit nr.... ne emer te Hotel ... ne rr.... ne Prizren, fotodokumentacioni i njehsorit elektrik me nr.96256854 ne vendin e ngjarjes, deklarata e deshmitareve-zyrtar te KEK-ut ne Prizren M.F, N.V dhe F.S.

Deshmitari – zyrtari KEK-ut M.F deshmon: si zyrtar KEK-ut distrikti ne Prizren, kemi shkuar bashke me koleget e mi per kontroll sipas urdhereses per kontroll nga ana e menagjerit, ke dhe kemi perpiluar procesverbal mbi kontrollin e kryer.Edhe pse gjate kontrollit te njehsori elektrik kemi hasur nje nderprese 1dhe 2 ku ne nderpresin nr.2 energjia e shpenzuar elektrike nuk regjistrohet ne njehsor elektrik, kjo eshte vertetuar permes nje kablle e cila eshte larguar nga siguresa, kjo kupton se kjo kabell eshte eliminuar pasi qe ka shpenzuar energji elektrike jashte njehsorit elektrik. Ne momentin e kontrollit sa me kujtohet mua edhe pse ne njehsor elektrik kane qene te kyqur edhe disa lokale te tjera e qe nuk e di se kush ka qene pronar, mirepo eliminimin e kabllor e kemi bere pikerisht tek njehsori elektrik ku ka qene i kyqur vetem si shfrytezues restorani – hoteli ... me shfrytezues Sh.M. Diten e kontrollit sa me kujtohet mua hoteli ka pasur punime – renovime ka qene duke u ndertuar, dhe per momentin dikush ka qene prezent gjate kontrollit bashke me neve zyrtaret, mirepo meqense ka kaluar nje kohe e gjate nuk po me kujtohet se kush ka qene prezent.

Deshmitari – N.V zyrtar i kedsit deshmon: meqense ka kaluar nje kohe gjate pasi qe deshmitari i merr ne shiqim shkresat e lendes dhe deklarone se ditën e kontrollit bashke me koleget e tije sipas urdhereses per kontroll e ka perpiluar procesverbalin e dt.31.01.2012, ku tek njehsori elektrik kane hasur nje nderpreres me numrat 1 e 2, e qe njehsori elektrik gjegjesisht nderprersi i ketij njehsori ka qene i kyqur i lidhur restorani i hotelit ..., njeherit aty kemi hasur edhe nje kabell te cilen e kemi eliminuar ngase e njehta ka qene duke shfrytezuar energjin elektrike jashte njehsorit elektrik.

Deshmitari – F.S zyrtar i kedsit deshmon: si zyrtar i kedsit ne Prizren, bashke me koleget e mi shkuam per kontroll dhe pas shqyrtimit te shkresave te lendes, deklarone se e kemi perpiluar dhe jam nenshkruer i procesverbalit te dt.31.01.2011 ne vendin e ngjarjes ku kemi hasur nje kabell i cili permes nje nderprersi e ka shfrytezuar energjin elektrike pa u regjistruar ne njehsorin elektrik, energjia elektrike ka qene duke u shfrytezuar nga ana e hotelit ... ne Prizren, edhe pse me

neve ka qene prezent nje qytetar gjate kontrollit qe nuk po me kujtohet se kush ka qene dhe ne çfare cilesie.

Gjykata i administroi te gjitha provat ne shkresat e lendes duke u bazuar ne deklaraten e dhene ne gjykate, nga deshmitaret zyrtaret e kedsit ne Prizren, M.F, N.V e F.S si ne procesverbalin e perpiluar gjate kontrollit te njehsorit elektrik me nr...., te hotel ... dhe me nr.te procesverbalit ... te dt.31.01.2011, transaksionet e konsumatorit me nr.... ne emer te hotel ... ne Prizren, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes i njehsorit elektrik me nr.....

Procesverbali i Kekut ne Prizren – distrikti ne Prizren, me nr.... te dt.31.01.2011.

Gjykata e degjoi perfaqesuesin e te demtuarit KEDS dega ne Prizren z.B.P, si dhe ne cilesin e deshmitareve zyrtaret e kedsit distrikti ne Prizren M.F, N.V e F.S.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e te akuzuarit Sh.M dhe tezen e mbrojtjesit te av.H.C, te nejtave nuk ia fali besimin, pasi qe mbrojtja e tyre ka per qellim ti shmanget pergjegjesise penale-juridike, per veprat penale vjedhje. Mbrojtja e tije ishte ne kundershtim te plote me provat materiale, e ne veqanti me deshmitet e deshmitareve, te demtuarit, procesverbalit te KEK-ut, fotodokumentacioni si dhe shkresat e tjera materiale, te cilat u administruan gjate shqyrtimit gjyqesor.

Nga arsyet e lartepermendura duke u bazuar ne te gjitha deklaratat dhe provat materiale te administruara ne shqyrtimn kryesor gjyqesor, pasi qe ne nje forme edhe vete i akuzuari ne mbrojtjen e tije e ka pranuar se ka qene duke e renovuar hotelin ... ne cilesin e pronarit edhepse ne ate njehsor elektrik ka pasur te kyqur edhe lokale – pronar te tjere, nga kjo konstatohet se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale te vjedhjes nga neni 252 par.1 te KPK-se, andaj te akuzuarin gjykata i shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin-denimin e pershkruar si ne dispozitivat e ketij aktgjykimi, duke e vertetuar ne teresi pergjegjesine e tije penale-juridike, pasi qe nuk eshte gjetur asnje rrethane e cila do ta perjashtonte eventualisht pergjegjesine e tije.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke e gjetur si rrethane posaqerisht renduese, shkallen e pergjegjesise penale, si dhe rrethanat nen te cilat eshte kryer vepra penale nga ana e te akuzuarit se motivi per kryerjen e kesaj vepre penale ka qene pervetsim i kunderligjshem pasuror per vehte apo personin tjeter – shfrytezim i paautorizuar i energjis elektrike, e si rrethane lehtesuese, ne kuptim te nenit 74, 75, 76 gjykata morri per baze edhe faktin se i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar, gjate shqyrtimit gjyqesor ka pasur qendrim tejet korrekt, gjere me tani nuk ka qene i gjykuar, do te thote se nuk ra ne kundershtim me normat pozitive te shoqerise, sjellja e mire e tije pas kryerjes se vepres penale, keshtu qe denimi i shqiptuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, eshte ne proporcion te plote me shkallen e pergjegjesise penale-juridike te te akuzuarit, andaj kjo mase sanksionuese do te ndikojte te i akuzuari qe ne te ardhmen te jetë i kujdesshem dhe te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal, dhe me kete edhe do te arrihet qellimi i denimit i parapare sipas dispozitave te KP-se.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr. 733/2011 të dt. 23.01.2017**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder këtij aktgjykimi palet e pakenaqura kane te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.